VENDIM
Nr.1051, datë 16.7.2008

PËR MIRATIMIN E PUBLIKIMIN ZYRTAR TË NOMENKLATURËS SË KOMBINUAR TË MALLRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 12 të ligjit nr.9461, datë 21.12.2005 "Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën doganore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e publikimin zyrtar të nomenklaturës së kombinuar të mallrave, 2008, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi nr.574, datë 19.11.2002 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e nomenklaturës së kombinuar të mallrave", dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi me miratimin e niveleve të tarifave doganore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha